



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 29, datë 22.01.2021

PËR CAKTIMIN E DATËS SË SEANCËS DISIPLINORE TË PROCEDIMIT DISIPLINOR NË NGARKIM TE PROKURORIT

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, germa b), të Kushtetutës, në nenin 138, pika 2, germat a), dhe b), të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 189, pika 1, germa a), dhe 190, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, të miratuar me Vendimin Nr.260, datë 17.11.2010 të KLP-së, me propozimin e Komisionit Disiplinor,

V E N D O S I:

1. Caktimin e datës 15 Shkurt 2021 ora 11.00, për zhvillimin e seancës dëgjimore, në lidhje me procedim disiplinor nr.104 prot., dt.15.01.2021, filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit _____, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.
2. Ky vendim i njoftohet menjëherë prokurorit _____ dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet i anonimizuar, në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA



ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SELTI



ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
VATË STAKAJ



ANËTAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
ESMERALDA KESHI

